

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit, N.A., nga fsh.... komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 me par.6 të KPRK, sipas aktakuzës së PTH –së në Ferizaj PP nr.1556-5/15 të dates 26.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me dt. 21.01.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Ismet Rrahmani, të dëmtuarit I.H. dhe përfaqësuesit të tij të autorizuar av.F.N., të pandehurit N.A. dhe mbrojtësit të tij me autorizim, av.J.R., të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N.A.**, nga fsh..... komuna Ferizaj, data e lindjes, nga i ati Sh. dhe e ëma M., e gjinisë R., i martuar prind i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion moler, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ...

ËSHTË FAJTOR

Se me dt.01.09.2015 rreth ores 07:55 min, në rrugën magjistrale Ferizaj-Gjilan përkatësisht përballë restorantit “...” në fshatin komuna Ferizaj, duke e drejtuar automjetin e markës “...”, me targa të regjistrimit ... duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 71/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka filluar tejkalimin e disa mjeteve përpara tij (kolonës së mjeteve), kalon në shiritin e kundërt qarkullues dhe e godet me pjesën e përparme m... – s... pa targa të rexhistrimit, i cili ishte duke lëvizur në shiritin e tij qarkullues në drejtim të Ferizajt e cila nga goditja përfundon i ndalur në anën e djathtë jashtë rrugës shikuar në drejtim të Gjilanit, ndërsa shoferi i automjetit “...” pas kontaktit fizik humb kontrollin mbi automjet dhe përfundon i ndalur në anën e majtë të drejtimin të lëvizjes i pëmbysur në anën e majtë ku pos dëmëve materiale si

pasojë e lëndimëve trupore të marrura në aksident ndërron jetë tani i ndjeri H.H., ku vdekjen e ka konstatuar mjeku kujdestar i emergjencës së Ferizajt dr.N.Q.,

me këte ka kryer veprën penale penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par.6 të KPK,

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,17,23,41,43,45,73 dhe 74 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPK-së, të akuzuarin N.A.,e:

GJYKON

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 /një/ vitë e 8 /tetë/ muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dënimin e shqiptuar do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 01.09.2015 deri më 05.10.2015 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 05.10.2015 deri më 25.11.2015.

I dëmtuari I.H. nga fshati komuna Viti për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 30.66 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcnimin e përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.1556-5/15 të dt.26.10.2015 e ka ngarkuar të pandehurin N.A. për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga nen. 378 par.9 lidhur me par.6 të KPRK-së, i cili në shqyrtimin fillestar të datës 25.11.2015 ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 21.01.2016, kurse Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri N.A., në shqyrtimin gjyqësor, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranojë fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 325 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, duke shprehur keqardhjen dhe duke i shprehur ngushëllime familjes së të dëmtuarit.

Me që i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 të KPPK-së se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: raporti i Qendrës Emergjente në Ferizaj nr... i dt.01.09.2015 si dhe raporti mjekësor për vdekje e dt.01.09.2015 e konstatuar nga dr.A.T., ekspertiza e komunikacionit e dt.08.10.2015 nga eksperti i komunikacionit ing.dipl.A.A., deklarata e të dëmtuarit I.H. e dt.29.09.2016, deklarata e të pandehurit e dt.26.10.2015, si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabim faktik, andaj shqyrtimi gjyqësor konform 356 të KPPK-së ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i akuzës – prokurori i shtetit Ismet Rrahmani ka deklaruar se mbetet pranë akuzës dhe kualifikimit juridike të veprës penale, se mbi bazën e pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit dhe provat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës, konstatohet se i pandehuri ka kryer veprën rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të shpallet fajtor dhe të shqiptohet dënimi i paraparë me

ligj, duke pasur parasysh rrethanat që i pandehuri e ka pranuar fajësinë si dhe kërkim faljen por gjithashtu të ketë parasysh edhe pasojat nga kryerja e kësaj vepre penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit av.F.N. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e pranon në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, duke propozuar që me rastin e matjes së dënimit gjykata ti ketë parasysh rrethanat rënduese, si mënyrën dhe pasojat e këtij aksidenti, duke propozuar që konform nenit 62 të KPK të pandehurit ti shqiptoj dënim plotësues marrja e lejes së vozitjes.

I dëmtuari I.H. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e përkrah në tërësi fjalën e përfaqësuesit të autorizuar av.F.N., duke shtuar se i bashkëngjitet ndjekjes penale si dhe mbetet pranë kërkesës pasurore- juridike.

Mbrojtësi i autorizuar i të pandehurit N.A., av.J.R., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, pasi që i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë ashtu ka kërkuar nga gjykata që me rastin e matjes së dënimit konform nenit 75 par.3 ti merr parasysh rrethanat lehtësuese, se i pandehuri nuk do të përsërisë vepra të tilla penale, se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, gjendja e tij sociale dhe emocionale, se i pandehuri është baba i katër fëmijëve, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin andaj duke pasur parasysh këto rrethana gjykata ti shqiptoj të pandehurit një dënim nën minimumin e paraparë ligjorë për këtë vepër penale.

I akuzuari N.A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij av.J.R., duke theksuar edhe njëherë se pendohem për këtë vepër penale dhe kërkoj falje personalisht për këtë.

Analizuar nga aspekti juridik në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 të KPRK, të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, deri sa i pandehuri me dt.01.09.2015 rreth ores 07:55 min në rrugën magjistrale Ferizaj-Gjilan përkatësisht përballë restorantit “.....” në fshatin komuna Ferizaj, duke e drejtuar automjetin e markës “...”, me targa të regjistrimit ... duke vepruar në kundërshtim me

dispozitat e nenit 71/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka filluar tejkalimin e disa automjeteve (kolonës së automjeteve) dhe gjatë këtij veprimi duke mos përshtat shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës me pjesën e përparme ndeshet me m... – s... të cilën ishte duke e drejtuar shoferi tai i ndjeri H.H., i cili në momentin e paraqitjes së rrezikut ishte duke lëvizur nga kahja e kundërt nga drejtimi i Gjilanit në drejtim të Ferizajt, ku pos dëmëve material si pasojë e lëndimëve trupore të marrura në aksident ndërron jetë tani i ndjeri H.H..

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nen. 73 të KPRK-së, si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale, keqardhjen për aksidentin e shkaktuar, se është hera e parë që ka kryer ndonjë veprë penale, është i martuar dhe prind i katër fëmijëve. Ndërsa si rrethana rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rezikshmerinë konkrete të veprës penale, dëmtimin e vlerës së mbrojtur, ku në rastin konkret kemi të bëjmë me jetën e njeriut, ku si pasojë e aksidentit pësoi me fatalitet tani i ndjeri H.H., pra jeta e tij u ndërpre nga para kohe, andaj Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim me burgim prej një vit e tetë muaj duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanave të kryerjes së veprës, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale, që dënimi me burgim të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por do të arrihet qëllimi ndëshkimorë dhe në kuptim të preventivës gjenerale të paraparë me nen. 41 të KPRK-së, që të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

I dëmtuari I.H. nga fshati komuna Viti për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450 të KPPRK-së, i pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40.88€ për ekspertizën e komunikacionit si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit nën kërcnimin e përbarimit me dhunë

Nga arsyet e sipër cekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr. 1273/15, dt.21.01.2016**

Sekretarja Juridike ,
Drita Ujupi

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.